

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza: Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/aktgjykimi-i-hages-perballe-historise-se-luftes-se-kosoves-i-514672
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:20:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d9aaf9a63807133aa0bf47db3e9a9cecf38a2dfee0ee51765248c12d14dbf85a
TEKSTI	c1ecc1f45cdbe5f59cd6e17bfa5c5d8473871b4ccb8c4566047dfd4f1b9d8faf
PAMJA	5d3572a4884a2e6dbe819f83f29a29c091a0c8c8d3a8ec11faab88925456fd6f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	51f42b2bcf8a7e292e6b474e7d6597f8eec037048855dfa721105d7a54ca0649
E MËPARSHMJA	d785277e9403c949cb553bf19c80f7f1da90fc2bb632112e2acf3563a8869377
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/51f42b2bcf8a7e292e6b474e7d6597f8eec037048855dfa721105d7a54ca0649>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

4 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

8 ORE ME PARE

Rrëzohet kërkesa e PD që të mos votohet drafti për pagat e magistratëve, Balla: Hipokrizi! Bardhi: Tërhiqeni ligjin

8 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

23 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

Aktualitet

Analiza: Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës

Studiuesit nuk presin që një aktgjykim i vetëm ta ndryshojë rrënjësisht historinë apo kujtesën kolektive për luftën e Kosovës, por mbetet e paqartë se çfarë peshe mund të ketë ai në mënyrën se si lufta do të interpretohet në të ardhmen.



17 Shtator 2026, 17:07
Nga G.M



Flamuj të UÇK-së në Marshin për Liri, që u organizua në Prishtinë më 12 shtator, katër ditë para shpalljes së aktgjykimit në Hagë.

KOSOVË- Aktgjykimi ndaj katër ish-udhëheqësve të UÇK-së përcakton përgjegjësi penale individuale, por ekspertët thonë se materialet e procesit mund të bëhen burim edhe për historianët.

Studiuesit nuk presin që një aktgjykim i vetëm ta ndryshojë rrënjësisht historinë apo kujtesën kolektive për luftën e Kosovës, por mbetet e paqartë se çfarë peshe mund të ketë ai në mënyrën se si lufta do të interpretohet në të ardhmen.

Një gjykatë mund të përcaktojë se kush është penalisht përgjegjës për një krim. Por, dokumentet, dëshmitë dhe konstatimet që prodhon një proces gjyqësor mund të jetojnë shumë më gjatë se vetë gjykimi. Kjo i jep një dimension tjetër aktgjykimit të 16 shtatorit ndaj katër prej figurave më të larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, i shpallën të katërt fajtorë për krime lufte dhe i dënuan me nga 13 deri në 25 vjet burg.

Ata u shpallën të pafajshëm për krime kundër njerëzimit. Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe përcakton përgjegjësinë penale të katër individëve, jo të UÇK-së si organizatë.

Por, përtej fatit juridik të tyre, procesi ka prodhuar një arkiv të gjerë dëshmish, dokumentesh dhe konstatimesh për krimet, strukturat e UÇK-së dhe rolin e drejtuesve të saj. Në aktgjykim, paneli konstatoi përgjegjësi penale të të akuzuarve për ndalimin arbitrar të 385 personave, trajtimin mizor të 49, torturimin e 303 dhe vrasjen e 96 personave.

Gjykatësit konstatuan, gjithashtu, se katër të akuzuarit kontribuan ndjeshëm në një "qëllim të përbashkët

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 17:03

Dënimi ndaj ish-krerëve të
UÇK-së/ Protesta edhe në
SHBA, shqiptarët nga Times
Square këndojnë "Mora fjalë"
(VIDEO)

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46

"Urime për look-un e ri"/ Muçi
ironizon deputeten socialiste,
Zegjine Çausi i përgjigjet
ashpër: O psikopat, na hape
barkun

kriminal" për shënjestrimin e personave të perceptuar si kundërshtarë të synimeve politike ose ushtarake të UÇK-së. Këto janë konstatime juridike të një gjykate të shkallës së parë.

Por, së bashku me materialin e administruar gjatë procesit, ato tashmë bëhen pjesë e një arkivi shumë më të gjerë për luftën e Kosovës. Pikërisht këtu takohen - ose përplasen - drejtësia, historia dhe kujtesa kolektive.

Për historianët dhe sociologët me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë, kjo nuk do të thotë se një aktgjykim mund ta shkruajë historinë. Por, ai mund të bëhet një prej burimeve përmes të cilave ajo interpretohet - veçanërisht për brezat që luftën nuk do ta njohin nga përvoja e drejtpërdrejtë.

"Nëse verdikti mbetet si i tillë, në rastin më të keq, do të ndikojë në krijimin e një narracioni të dytë për natyrën e UÇK-së", thotë për Radion Evropa e Lirë Ibrahim Gashi, profesor i Historisë në Universitetin e Prishtinës.

Aktgjykimi si burim, jo si histori

Florian Bieber, drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore, nuk pret që aktgjykimin të ndryshojë në mënyrë thelbësore narrativën historikë për luftën e Kosovës.

"Dyshoj se do të ndodhë. Aktgjykimet e mëparshme të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe gjykatave të tjera nuk i kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore narrativën historikë", thotë Bieber për Radion Evropa e Lirë.

Për të, duhet bërë një dallim themelor ndërmjet punës së gjykatës dhe asaj të historianit. Procesi penal kërkon të përcaktojë nëse individë konkretë mbajnë përgjegjësi penale për krime konkrete. Historia kërkon një pamje më të gjerë: kontekstin politik dhe ushtarak, zhvillimet në terren, raportet mes strukturave dhe shoqërisë dhe një shumëllojshmëri burimesh që nuk kanë domosdoshmërisht të njëjtën peshë në një sallë gjyqi.

Në rastin Thaçi dhe të tjerët, një prej çështjeve qendrore ishte mënyra se si funksiononte UÇK-ja dhe raporti i katër të akuzuarve me strukturat e saj. Bieber thotë se shumica e studiuesve dhe vëzhguesve e kanë parë UÇK-në si një strukturë relativisht të decentralizuar, pa një hierarki të fortë, dhe nuk pret që një aktgjykim i vetëm ta përmbyjë këtë interpretim.

Por, kjo nuk e bën procesin gjyqësor të parëndësishëm për historianët. Në gjykim u dëgjuan më shumë se 130 dëshmitarë dhe u administrua një sasi e madhe materialesh.

Për studiuesit, vlera e një procesi të tillë mund të jetë jo vetëm te përfundimet juridike të gjykatës, por edhe te materiali që ai ka nxjerrë në sipërfaqe.

"Sigurisht që kjo do t'i nënshtrohet hulumtimit. Do të theksoja se ekziston një dallim ndërmjet asaj që është interesante dhe relevante për një hetim penal dhe hulumtimit historik. Pyetjet janë të ndryshme, pasi historia rrallë merret me përcaktimin e përgjegjësisë. Megjithatë, historianët e konfliktit dhe të UÇK-së do të duhet të merren me këtë rast", thotë Bieber.

Gashi e sheh aktgjykimin si një burim që historianët duhet ta shqyrtojnë, por jo si dokumentin që mund ta përcaktojë i vetëm historinë e luftës.

"Mendoj që kjo do të jetë vetëm një prej referencave, jo më tepër. Pra, vetëm një referencë. Një mori librash janë shkruar që e kanë një narracion të qëndrueshëm dhe që korrespondon me faktet që kanë ndodhur në terren", thotë Gashi.

Ai përmend, mes të tjerëve, autorë dhe ish-zyrtarë perëndimorë si Madeleine Albright, Wesley Clark, James Pardew dhe Marc Weller, të cilët kanë shkruar për luftën, diplomacinë dhe ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë.

Sipas Gashit, historiografia nuk do të mbështetet vetëm në dokumentet gjyqësore. Dëshmitë e protagonistëve, burimet ndërkombëtare, historia gojore dhe përvoja e popullatës civile do të mbeten pjesë e materialit mbi të cilin do të shkruhet historia e konfliktit.

Edhe vetë aktgjykimin i 16 shtatorit nuk e ka marrë ende formën e tij përfundimtare. Ai është i shkallës së parë dhe përfundimet e tij mund të sfidohen në apel - një tjetër arsye pse pesha e tij afatgjatë në histori nuk mund të përcaktohet ende.

E ardhmja e një lufte të së shkuarës

Por, historia akademike është vetëm njëra pjesë e kësaj çështjeje. Tjetra është kujtesa kolektive, apo mënyra se si një shoqëri e mban mend, interpreton dhe ua transmeton brezave ngjarjet e së kaluarës.

Për Shemsi Krasniqin, profesor i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, ndikimi i aktgjykimin brenda Kosovës mund të jetë më i kufizuar. Ai argumenton se për një pjesë të madhe të shoqërisë kosovare, perceptimi për luftën

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:22

Me cigare në dorë/ Monika Kryemadhi bashkëbisedon me protestuesit para SPAK: Bashkohuni dhe organizohuni mes jush!

më të klikuarat

Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente fals/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasi/ Eno Agasi zhduku verën miliona euro nga kantina djalit të xhaxhait

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

nuk është krijuar nga dokumentet gjyqësore, por nga përvoja e drejtpërdrejtë.

"E vërteta jonë është ajo e vërtetë, të cilën e kemi përjetuar me jetën tonë, me vuajtjen tonë, me dhimbjet tona, me përpjekjet, me angazhimet, me djersën e me gjakun, me të gjitha. Ndërsa, ndërkombëtarët janë më të ftohtë në këtë aspekt. Ata i shohin gjërat sipas letrave, sipas vendimeve institucionale dhe nuk e kanë ndjesinë që e kemi ne", thotë Krasniqi për Radion Evropa e Lirë.

Për këtë arsye, ai nuk pret që aktgjykimi ta ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si lufta dhe UÇK-ja kujtohen sot brenda Kosovës.

"Përbrenda Kosovës, nuk besoj që do të ketë ndikim në këtë aspekt, për shkak se populli i Kosovës e di shumë mirë historinë e vet, është shumë i vetëdijshëm për vlerat e UÇK-së, për vlerat e luftës për liri, për domosdoshmërinë e luftës për liri", thotë Krasniqi.

Por, me kalimin e kohës, raporti mes përvojës së drejtpërdrejtë dhe dokumenteve mund të ndryshojë. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme kur vëmendja zhvendoset nga brezi që e ka përjetuar luftën tek ai që do ta njohë atë vetëm përmes librave, arkivave, filmave, dëshmimeve dhe vendimeve gjyqësore.

"Është rrethanë komplekse që e vështirëson situatën. Por, të bëhemi parashikues se si do të shpjegohet historia pas 25 vjetësh ose 50 vjetësh, është pak e vështirë. Nuk e dimë se çfarë ngjarjesh të tjera do të ndodhin ndërkohë dhe cilët narrativë do të konsolidohen dhe cilët do të dominojnë, rreth cilëve do të ketë pajtueshmëri ose konsensus", thotë Krasniqi.

Një luftë me narrativë të ndryshëm

Aktgjykimi i 16 shtatorit nuk hyn në një histori të luftës që po shkruhet për herë të parë nga një gjykatë. Para tij ekziston tashmë një korpus aktgjykimesh ndërkombëtare për krimet e kryera në Kosovë.

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë u ka shqiptuar disa dënime ish-zyrtarëve të lartë politikë, ushtarakë dhe policorë serbë për krimet e kryera në Kosovë.

Dënimet e shqiptuara në Hagë për luftën e fundit në Kosovë

Megjithatë, aktgjykimet ndërkombëtare nuk u kanë dhënë fund përplasjeve rreth mënyrës se si interpretohen luftërat e viteve '90.

"Përvoja e aktgjykimeve të gjykatave ndërkombëtare në formësimin e narrativëve historikë nuk është inkurajuese. Gjatë 25 vjetëve të fundit, aktgjykimet shpesh janë pranuar vetëm kur janë përshtatur me narrativin kombëtar dhe janë refuzuar kur nuk janë përshtatur", thotë Bieber.

Ai pret që edhe aktgjykimi ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit të lexohet në mënyra të ndryshme në Kosovë dhe në Serbi.

"Do të prisja që nacionalistët serbë të ndihen të vërtetuar në pikëpamjet e tyre, duke injoruar faktin se shumë më tepër oficerë serbë janë dënuar për krime më të rënda, për të mos përmendur shumë të tjerë që nuk janë gjykuar fare. Ndërsa në Kosovë tashmë po shohim një refuzim të bazuar në argumentin e gabuar se aktgjykimi, në njëfarë mënyre, kërcënon të dhënat historike", thotë Bieber.

Gashi, po ashtu, pret që qarqet nacionaliste në Serbi ta përdorin aktgjykimin si argument për narrativin e tyre mbi luftën në Kosovë. Dhe, për këtë arsye, ai thotë se puna e historianëve bëhet edhe më e rëndësishme.

"Ne, historianët, kemi shumë detyrë të përdorim argumente nga memoria kolektive, nga dëshmitë që japin protagonistët e ndryshëm, përmes asaj që quhet histori gojore, si dhe duhet të marrim referencat e autorëve perëndimorë që kanë pasur qasje dhe informacion nga terreni", thotë Gashi.

Por, kalimi i kohës ngre edhe pyetjen se sa gjatë mund të ruhet kujtesa e drejtpërdrejtë për luftën. Krasniqi beson se ajo do të vazhdojë të përcillet për dekada.

"Unë jam i sigurt që për kohë të gjatë, sigurisht do të shkojnë dekada dhe kjo përvojë nuk do të harrohet. E si do të harrohet kjo, që është e dokumentuar, e vizualizuar, e shkruar, e estetizuar më pas me krijime artistike, letrare, filmike etj? Nuk do të harrohet", përfundon historiani./REL

Aktualitet

17 Shtator 2026, 15:48

Vendimi ndaj Hashim Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë/
Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protestë:
Qëndrimi ynë nuk ndryshon

Ish-krerët e UÇK-së KOSOVA- Vendimi i Hagës në lidhje me ish-krerët e UÇK-së ka nxitur revolta në Kos...

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/
Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet
në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre
identitete

Aktualitet

17 Shtator 2026, 15:08

Haga dënoi me 81 vite burg në total ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë
nisin protestat, kërkojnë drejtësi: MARRE

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:45

Grabitën me dhunë dy pika karburanti në
Bulqizë, identifikohet njëri prej autorëve
dhe shpallet në kërkim një tjetër


Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:35

Pjesë e objektit të EULEX-it përfshihet
nga zjarri në protestën kundër dënimit të
ish-krerëve të UÇK-së

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:30



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.